



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 17.04.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 12.04.2024 të parashtruar nga

"CAPITAL X FET " SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja higjienike e objekteve Komunale ", Nr. i prokurimit- 632-24-14124-2-1-1 dhe Nr. i brendshëm-632-23-199-211, nxjerr:

**V E N D I M**

1. **Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim të Operatori Ekonomik " CAPITAL X FET " SH.P.K., e dt.12.04.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja higjienike e objekteve Komunale ", Nr. i prokurimit- 632-24-14124-2-1-1 dhe Nr. i brendshëm-632-23-199-211, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 08.04.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 08.04.2024;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

**A r s y e t i m**

Operatori Ekonomik " CAPITAL X FET " SH.P.K. me dt.12.04.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja higjienike e objekteve Komunale ", Nr. i prokurimit- 632-24-14124-2-1-1 dhe Nr. i brendshëm-632-23-199-211.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 17.04.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj se Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar Deklaratën nën betim siç duhet sepse nuk ka shënuar emrin dhe numrin e brendshëm të aktivitetit të prokurimit , nuk qëndron, ngase një gjë e tillë nuk kërkohet në FDT e as në LPP-ë .

Pretendimi juaj se Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka prezantuar listën e projekteve në tri vitet e fundit, por te kontrata dhe referenca me OE privat nuk ka ofruar dëshmi të transaksioneve bankare që ka realizuar kontratën, nuk qëndron, sepse ky operator i plotëson kërkesat e Autoritetit kontraktues në FDI, me kontratat e realizuara me Autoritetet kontraktuese (K.Deçanit, Arkivë Kosovës, Spitali në qytetin e Ferizajit...)

Pretendimi juaj se Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka parapare pushimet vjetore për 20 punëtorët, nuk qëndron, sepse i mëjti ka prezantuar një deklaratë të nënshkruar dhe të vulosur ku deklaron se **"të gjithë të punësuarit do t'i paguaj me rregull dhe sipas kërkesave të dosjes së tenderit për të gjitha kategoritë dhe pozicionet e përcaktuara në dosje duke përfshirë pagën, trustin dhe obligimet tjera që dalin nga marrëdhënia e punës"**.

Pretendimi juaj se Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë në analizën financiare nuk ka parapare pushimet vjetore të punëtorëve nuk qëndron, sepse Autoriteti kontraktues ka kërkuar analizë financiare në të cilën parashihen shpenzimet për pagat e punëtorëve:

Operatori Ekonomik duhet te dorëzoj analizën financiare në të cilën përfshihen pagat e punëtorëve për numrin e kërkuar, shpenzimet e materialit dhe të detyrimet tatimore.

Analizë financiare e vulosur dhe nënshkruar nga Operatori Ekonomik.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;

**Faton Gataj**  
  
**Menaxher i Zyrës së Prokurimit**  
